

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7016
E hënë, 9 tetor 2023
Çmimi 0.50

Izraeli shpall gjendje lufte

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

ÇMIMI I PRANIMIT TË ANËTARËVE TË RINJ NË BE MUND TA ULË ENTUZIAZMIN PËR ZGJERIM

FAQE 3



Përderisa në mesin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian është rritur mbështetja për procesin e zgjerimit, diplomatët

në Bruksel kanë shprehur drojë se kur të nisin diskutimet rreth zgjerimit, entuziazmi për pranimin e anëtarëve të rinj

mund të bjerë. Disa liderë kanë thënë se viti 2030, si afat për t'u bërë gati për zgjerim, është një shtytje e mirë politike

KURTI: INVESTIMET NË ARMATIM JANË RRRITUR PËR 191 PËR QIND

FAQE 3



SVEÇLA: NË SULMIN NË BANJSKË MORI PJESË BASHKËPUNËTORI I AFËRT I DJALIT TË VUÇIQIT

FAQE 4



OPINION

TË BASHKUAR PËR KOSOVËN

F. 5

Shkruan:
Ditmir BUSHATI,
ish-ministër i
Punëve të Jashtme
i Shqipërisë



AKTUALE



ARRESTOHET NJË PERSON, DYSHOHET PËR PLANIFIKIM TË NJË SULMI TERRORIST NË KOSOVË

F. 6

LISTA E TRASHËGIMISË KULTURORE NË MBROJTJE TË PËRKOHSHE PASUROHET ME 23 ASETE TË REJA

F. 6

EKONOMI



SHËRBIME STABILE TË TELEFONISË MOBILE, JO PARA MARSIT 2024

F. 8

SPORT



PRISHTINA NDAHET NË PAQE ME BALLKANIN, LLAPI MPOSHTI LIRINË

F. 10

RENOVA
PUTZ
Mqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Izraeli shpall gjendje lufte

Sulmet ajrore të Izraelit në Rripin e Gazës rrafshuan një numër të madh të ndërtesave të banimit. Ministria e Shëndetësisë në këtë rajon tha se 313 njerëz u vranë dhe gati 2 000 të tjerë u plagosën. Forcat izraelite u vunë në kundërsulm pasi militantët palestinezë të Hamasit nisën t'i sulmonin papritur caqet izraelite më 7 tetor



JERUSALEM, 8 TETOR - Kabineti i sigurisë së Izraelit ka shpallur gjendje lufte pas sulmeve të grupit militant palestinez të Hamasit, që kanë lënë të vrarë mbi 600 persona në Izrael.

Zyra e kryeministrit izraelit, Benjamin Netanyahu, tha se ky vendim u mor për shkak se shteti i u përball "me sulme terroriste nga Gaza".

"Lufta iu imponua shtetit të Izraelit nga sulmet vrastare terroriste që nisën nga Rripi i Gazës në orën 06:00 të ditës së djeshme", u tha në njoftim.

Aty nuk u dhanë më shumë detaje, por Netanyahu më herët kishte deklaruar se shteti i tij është në luftë dhe ushtria premtoi se do të kundërpërgjigjej ashpër në Gaza.

Për të dytën ditë me radhë forcat izraelite po përleshën me militantët e Hamasit në pjesën jugore të shtetit.

Ndërkaq, zyrtarët shëndetësorë palestinezë njoftuan të dielën se numri i viktimave u rrit në 370 dhe mbi 2 000 janë plagosur.

Ushtria izraelite tha më 8 tetor se synon t'i evakujë të gjithë izraelitët që jetojnë afër Rripit të Gazës brenda 24 orëve përderisa ka dislokuar mijëra luftëtarë për t'u përballur me militantët e Hamasit, që janë infiltruar brenda Izraelit. "Misioni ynë është që në 24 orët e ardhshme t'i evakujmë të gjithë banorët që jetojnë

rreth Gazës", tha zëdhënësi i ushtrisë, Daniel Hagari, duke shtuar se luftimet po vazhdojnë për t'i "shpëtuar pengjet" që po mbahen nga militantët. "Ka dhjetëra mijëra ushtarë në zonë. Ne do të arrijmë të secili komunitet derisa t'i vrasim të gjithë terroristët në Izrael", tha ai për gazetaret.

Grupi palestinez Hamas nisi një sulm të befasishëm ndaj Izraelit më 7 tetor, gjatë të cilit u vranë afër 500 persona.

Kjo ishte dita më vdekjeprurëse e dhunës në Izrael që 50 vjet.

Konflikti u përhap pasi pati sulm nga Libani në veri të Izraelit, përgjegjësia për të cilin e mori grupi Hezbollah, duke thënë se sulmi u krye "në solidaritet" me popullin palestinez.

Izraeli u kundërpërgjigj me sulme të artilerisë në Liban dhe përmes një sulmi me dron ndaj një pike të kontrollit të Hezbollahut pranë kufirit, tha ushtria. Nuk ka raportime për viktima nga këto sulme.

Inkursioni nga Gaza në jug të Izraelit, që është më i madhi në dekada, mund t'i minojë përpjekjet që mbështeten nga Shtetet e Bashkuara për bashkimin e rajonit sa i përket sigurisë dhe mund t'i kërcënojë aspiratat palestineze për shtetësi dhe ambiciet e mbështetësit

kryesor të Hamasit, Iranit.

Luftëtarët e Hamasit nisën sulmin e tyre mëngjesin e 7 tetorit duke goditur me breshëri raketash jugun e Izraelit. Sulmet me raketa iu mundësuan luftëtarëve të grupit të infiltrohen në Izrael nga Gaza - një rrip toke që është shtëpi e 2.3 milionë palestinezëve. "Ne do të hakmerremi për këtë ditë", tha të shtunën kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu. Ai, po ashtu, ka paralajmëruar se i pret një "luftë e gjatë dhe e vështirë" kundër Hamasit.

Një zëdhënës i ushtrisë izraelite tha se operacionet po vazhdojnë të dielën në tetë zona përreth Gazës, ndërkaq televizioni "Al Hadath" citoi Gjysmëhënën e Kuqe palestineze të ketë thënë se 18 persona janë vrarë pasi Izraeli shënjestroi dy shtëpi në qarkun Beit Hanun të Gazës.

Në veri, Hezbollahu që mbështetet nga Irani, tha përmes një deklaratë se kreu një sulm me raketë dhe artileri në tri caqe, përfshirë një pikë ku ishte vendosur një radar në fermat Sheba të pushtuar nga Izraeli. Kjo copë toke është pushtuar nga Izraeli më 1967 dhe Libani pretendon se i përket atij. Izraeli u kundërpërgjigj me sulm artilerie në jug të Libanit.

Lideri i Hamasit, Ismail

Haniyeh, tha se sulmi që nisi në Gaza do të përhapet në Bregun Perëndimor dhe Jerusalem. Banorët në Gaza po përballen që 16 vjet me një bllokadë izraelite.

Gjatë fjalimit, Haniyeh përmendi kërcënimet ndaj xhamisë Al-Aksa në Jerusalem, bllokadën e vazhdueshme izraelite në Gaza dhe normalizimin e raporteve në mes të Izraelit dhe shteteve të rajonit. "Sa herë iu kemi paralajmëruar se populli palestinez po jeton në kampe të refugjatëve për 75 vjet, dhe ju keni refuzuar që t'i njihni të drejtat e popullit tonë?", tha ai.

Zyra e Netanyahu tha se kabineti i tij i sigurisë ka miratuar hapat për t'i shkatërruar aftësitë ushtarake dhe qeverisëse të Hamasit dhe Xhihadit Islamik - një tjetër grup militant - "për vite të tëra" përfshirë ndërprerjen e energjisë elektrike, furnizimeve me karburante dhe dërgimin e mallrave për në Gaza.

Autoriteti Palestinez të dielën dorëzoi kërkesë për një mbledhje urgjente të ministrave të Jashtëm të Ligës Arabe.

Kërkesa për mbledhje vjen në kohën e "agresionit të vazhdueshëm dhe brutal të Izraelit kundër popullit palestinez, përfshirë edhe përshkallëzimin nga hyrja në

xhaminë Al-Aksa të mijëra kolonëve", tha Muhannad Al Alkhouk, ambasador në Ligën Arabe.

Pas nisjes së sulmit masiv të Hamasit, shtetet në mbarë botën i ofruan mbështetje Izraelit dhe theksuan se ai ka të drejtë ta mbrojë veten. Presidenti amerikan Joe Biden, po ashtu, paralajmëroi shtetet e tjera që janë "palë armiqësore e Izraelit", që të mos tentojnë ta shfrytëzojnë situatën. "Bota po shikon", tha Bideni gjatë një adresimi nga Shtëpia e Bardhë.

Në mbarë Lindjen e Mesme ka pasur edhe demonstrata në mbështetje të Hamasit, me flamujt e Izraelit dhe të ShBA-së që janë djegur në Irak, Liban, Siri dhe Jemen. Ndërkaq, Irani dhe Hezbollahu kanë përgëzuar Hamasin për sulmin.

Zëvendëshefi i Hamasit, Salehal-Arouri, tha se grupi ka kapur një numër të madh robërish izraelitë, përfshirë zyrtarë të lartë. Ai tha se Hamasi ka mjaft pengje sa ta detyrojë Izraelin që t'i lirojë të gjithë palestinezët që janë në burgje.

Hamasi ka argumentuar se sulmi është kryer për shkak të, siç ka thënë, përshkallëzimit të sulmeve izraelite ndaj palestinezëve në Bregun Perëndimor dhe Jerusalem.

Kurti: Investimet në armatim janë rritur për 191 për qind

EPOKA ERE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 8 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se gjatë dy vjetëve e gjysmë të qeverisjes ekzekutivi që ai udhëheq ka dyfishuar buxhetin për Forcën e Sigurisë së Kosovës. “Ministrisë së Mbrojtjes iu ndanë 100 milionë euro buxhet për herë të parë në vitin 2021. Prej atëherë, minimumi është aq, kurse tavanin sa vjen e ngritët. Për vitin 2023, buxheti për ushtrinë është 141 milionë euro, më shumë se dyfishim krahasuar me kohën kur morëm në drejtim qeverinë”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.

Kurtika theksuar se gjatë kësaj periudhe janë rekrutuar afër 2 000 ushtarë të rinj. “Kemi rekrutuar 1 852 ushtarë të rinj, duke rritur numrin e përgjithshëm të ushtarëve për më shumë se 2/3. Ushtria jonë sot është më profesionale dhe më e përgatitur sepse gjatë kësaj



periudhe 3 325 ushtarakë kanë përfunduar trajnime profesionale jashtë vendit. Ata janë të pajisur më mirë se asnjëherë më parë, sepse investimet në armatim janë rritur për 191 %. Arsenalit tonë ushtarak ia shtuam

dronët e mirënjohur luftarak Bayraktar”, ka shkruar Kurti. Ai ka shtuar se hoqën kufizimin në numër të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe e hapëm atë për çdo të re e të ri deri në moshën 25 vjeç, ndërkaq lëndën “Edukim në

Siguri” e bëmë pjesë të kurrikulave shkollore për nxënësit e ciklit të mesëm të lartë.

Kurti ka thënë se në vitin 2021 Forca e Sigurisë së Kosovës, bashkëzarkoi me ushtrinë amerikane në

misionin e saj të parë paqeruajtës në Kuvajt. “Për të vazhduar pastaj një vit pas me misionin bashkëzarkues me ushtrinë britanike në ishujt Falkland. Kurse në fillim të këtij viti dëshmoi para botës përgatitjet dhe aftësitë e saja në misione të kërkim-shpëtimit kur në Turqi shpëtoi katër jetë njerëzish nga rrënojat e tërmetit shkatërrues atje. Përmes marrëveshjeve të nënshkruara të bashkëpunimit me Mbretërinë e Bashkuar, Shqipërinë, Letoninë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Kroacinë, gjatë këtyre dy vjet e gjysmë qeverisje, dhe plot tjera që janë drejt finalizimit, kemi thelluar edhe më tej raportet me partnerë tanë strategjikë. E në Defender Europe 21 dhe 23 u rreshtuam krah për krah me aleatët tanë në ndërmarrjen më të madhe të ushtrimeve ushtarake në kontinentin e Evropës që prej përfundimit të Luftës së Dytë Botërore”, ka deklaruar kryeministri Kurti.

Sveçla: Në sulmin në Banjskë mori pjesë bashkëpunëtori i afërt i djalit të Vuçiqit

PRISHTINË, 8 TETOR - Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka publikuar një dokument personal të një serbi, që tha se janë gjetur pas sulmit ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator. Sipas Sveçlës, dokumenti i përket Millorad Jevtiqit që “njihet si një ndër bashkëpunëtorët më të afërt të Danillo Vuçiqit, djalit të presidentit serb Aleksandar Vuçiq”. “Nga pesë vizitat e fundit të djalit të Vuçiqit në Kosovë, katër herë ata kanë qenë bashkë në të njëjtën veturë”, pretendoi Sveçla. Ai tha se gjetja e këtij dokumenti dëshmon se Jevtiqi ka qenë i përfshirë në sulmin ndaj Policisë së Kosovës.

Ministri kosovar tha se Jevtiqi është identifikuar si një ndër sulmuesit e ushtarëve të KFOR-it më 29 maj në Zveçan në veri të Kosovës. “Mbetet që organet e sigurisë dhe hetimet të zbulojnë se përveç Vuçiqit dhe strukturave të larta shtetërore serbe, a ka qenë edhe djali i tij [i përfshirë] në planifikimin dhe organizimin e sulmit terrorist në Banjskë të Zveçanit”, ka shkruar Sveçla në “Facebook”.

Më 24 shtator një grup i



armatosur sulmoi një njësi patrulluese të policisë së Kosovës në një rrugë në fshatin Banjskë, duke vrarë rreshterin Afrim Bunjaku.

Më pas, grupi i sulmuesve u strehua në manastirin në Banjskë, prej ku vazhdoi përlëshjet me zyrtarët policorë.

Gjatë përlëshjeve, sipas autoriteteve kosovare, janë vrarë tre sulmues.

Kosova ka fajësuar për këtë sulm terrorist Serbinë, por Beogradi ka mohuar se ka gisht në të.

Millan Radoiçiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe - partisë kryesore të serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit zyrtar, ka pranuar se ka organizuar dhe ka marrë pjesë në sulmin në Banjskë.

Kosova ka publikuar dëshmi për përfshirjen e Radoiçiqit në

ngjarjet në veri, përfshirë edhe pamje të incizuara me dron ku ai shihet i veshur me uniformë dhe i armatosur në manastirin e Banjskës më 24 shtator. Pas sulmit, Kuvendi i Kosovës ka miratuar një rezolutë e cila kërkon një hetim ndërkombëtar për ta përcaktuar rolin e Serbisë në sulmin në Banjskë.

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë dënuar ashpër sulmin, teksa u kanë

bërë thirrje palëve të kthehen në dialogun për normalizimin e raporteve që ndërmjetësohet nga Brukseli.

Në BE, po ashtu, disa shtete kanë kërkuar që Serbia të ndëshkohet nëse vërtetohet se ka qenë e përfshirë në sulm. Blloku evropian ka deklaruar se po pret përfundimin e hetimeve dhe më pas do të vendosë se çfarë hapash do të ndërmarrë.



Çmimi i pranimit të anëtarëve të rinj në BE mund ta ulë entuziazmin për zgjerim

Përderisa në mesin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian është rritur mbështetja për procesin e zgjerimit, diplomatët në Bruksel kanë shprehur drojë se kur të nisin diskutimet rreth zgjerimit, entuziazmi për pranimin e anëtarëve të rinj mund të bjerë. Disa liderë kanë thënë se viti 2030, si afat për t'u bërë gati për zgjerim, është një shtytje e mirë politike

PRISHTINË, 8 TETOR - Përderisa në mesin e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian është rritur mbështetja për procesin e zgjerimit, diplomatët në Bruksel kanë shprehur drojë se kur të nisin diskutimet rreth zgjerimit, entuziazmi për pranimin e anëtarëve të rinj mund të bjerë. Sipas kriterëve të tanishme, shtetet që janë më pak të zhvilluara janë neto shfrytëzues të buxhetit të përbashkët të BE-së, ndërsa ato më të pasura janë neto kontribuuese. Nëse bëhet një llogaritje në bazë të këtyre kriterëve, atëherë pothuajse të gjithë anëtarët aktualë, me përjashtim të Bullgarisë, do të paguanin më shumë sesa fondet e BE-së që u jepen shteteve anëtare.

Politika e kohezionit dhe ajo e bujqësisë janë dy fusha që tradicionalisht marrin pjesën më të madhe të buxhetit. Këto politika

synojnë që t'i zvogëlojnë dallimet mes shteteve anëtare në bazë të solidaritetit. Falë kësaj politike, për shembull, kryeministrja e Estonisë, Kaja Kallas, ka deklaruar se kur shteti i saj është anëtarësuar në BE, ka pasur Bruto Prodhimin Vendor (GDP) në nivel prej 48-përqindësh të mesatares së bllokut, ndërsa sot GDP-ja është mbi 80 për qind. Por, edhe shtete të tjera kanë shënuar rritje të Bruto Prodhimit të Brendshëm falë anëtarësimit në bllokun evropian.

Por, nëse në BE do të hynin gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor, së bashku me Ukrainën, Moldavinë dhe Gjeorgjinë, atëherë mesatarja e BE-së do të binte dukshëm dhe, si pasojë e kësaj, disa shtete që aktualisht janë anëtare, nuk do të përmbushnin më kriteret që u mundësojnë të përfitojnë nga politika e kohezionit.

Nëse bëhet një llogaritje - sipas

kritereve aktuale për nëntë shtetet e reja anëtare, BE-ja do të duhej të ndante 260 miliardë euro për buxhetin 7-vjeçar. Prej kësaj shume, vetëm për Ukrainën për shkak të madhësisë së territorit që ka, nivelit të ulët të GDP-së për kokë banori dhe numrit të popullsisë - do të shkonin 186 miliardë euro, ndërsa për tetë vendet e tjera do të ishin në dispozicion 74 miliardë euro.

Këto llogaritje janë bërë nga shërbimet e Këshillit të BE-së dhe janë përfshirë në një dokument të brendshëm pune, i cili ka rrjedhur në medie. Ndonëse nuk kanë dashur të komentojnë për këtë dokument, në BE nuk kanë hedhur poshtë as raportimet për të. Por, kur janë pyetur rreth shpenzimeve që mund të ketë blloku pas pranimit të anëtarëve të rinj, nga Komisioni Evropian kanë thënë se "projektimi i buxhetit nuk mund të kopjohet automatikisht nga e kaluara dhe mund të ndryshojë për t'iu përshtatur rrethanave të reja".

Por, në BE kanë thënë se thirrjet për nisjen e përgatitjeve të nevojshme për zgjerim nënkuptojnë edhe nisjen e diskutimeve për pasojat financiare. Kështu ka deklaruar edhe presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel.

BE-ja ka miratuar kornizën buxhetore deri në vitin 2027. Por, në

buxhetin e ri duhet të përfshihen edhe llogaritjet e reja për t'i siguruar mjetet e nevojshme edhe për pranimin e vendeve të reja anëtare.

Rritja e mbështetjes për zgjerimin

Zgjerimi është shndërruar në një prej temave kryesore në takimet e nivelit të lartë në BE dhe mbështetja për këtë proces ka shënuar rritje të madhe.

Edhe në samitin e fundit joformal të BE-së, shumë liderë, përfshirë edhe presidenten e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, kanë thënë se "edhe BE-ja edhe vendet kandidatë duhet ta kryejnë pjesën e tyre të punës për t'u bërë gati për zgjerim". Megjithatë, liderët e bllokut kanë thënë se shtetet aspiruese duhet t'i zbatojnë reformat që kërkohen, veçmas në fushën e sundimit të ligjit.

Disa liderë kanë thënë se viti 2030, të cilin e ka përmendur presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, si afat për t'u bërë gati për zgjerim, është një shtytje e mirë politike. Por, për disa liderë të BE-së kjo datë duket tepër e largët e për të tjerët tepër e shpejtë.

Mbështetje për zgjerimin u dha edhe përmes Deklaratës së

Grandës, që u miratua më 6 tetor. Në tekstin e saj u tha se zgjerimi është një investim gjeostrategjik për paqe, siguri, stabilitet dhe prosperitet në kontinentin evropian. Sipas kësaj deklarate, zgjerimi do ta zvogëlojë pabarazinë mes vendeve dhe do t'i forcojë vlerat mbi të cilat është ndërtuar BE-ja. "Duke shikuar para drejt një blloku më të zgjeruar, si BE-ja ashtu edhe vendet e ardhshme anëtare duhet të bëhen gati. Vendet aspirante duhet ta përshpejtojnë punën e tyre në reforma, në veçanti në fushën e sundimit të ligjit, në përputhje me qasjen e zgjerimit sipas parimit të meritave individuale dhe me asistencë të BE-së. Paralelisht Union duhet të vendosë themelet për ta bërë unionin gati për t'u zgjeruar. Në do t'i paraqesim ambicjet tona afatgjatë dhe mënyrën se si t'i arrijmë ato", u tha në deklaratë.

Por, kjo duket më shumë mbështetje politike e shkaktuar nga agresioni i Rusisë në Ukrainë, që ka krijuar një moment të ri politik në Evropë. Kjo luftë, që Rusia nisi shkurtin e vitit të kaluar, ka rikujtuar se në kontinentin e Evropës liria më nuk mund të merret si e garantuar vetvetiu dhe se zgjerimi i BE-së është vërtet një investim në paqe dhe stabilitet, e jo vetëm në rritjen e tregut.

Të bashkuar për Kosovën



Shkruan: Ditmir BUSHATI, ish-ministër i Punëve të Jashtme i Shqipërisë

Bota u zgjua dje me imazhe të tmerrshme të sulmeve terroriste të Hamasit kundër Izraelit, të cilat me të drejtë u dënuan me ashpërsi nga e gjithë bota demokratike.

Edhe në Shqipëri, të gjithë krahët e politikës për pak minuta u bashkuan në mesazhet e tyre për dënimin e sulmeve terroriste të Hamasit kundër Izraelit. Mesazhet ishin thuajse të njëjta, në pajtim të plotë me praktikën e qëndrimeve të mbajtura nga Shqipëria për të tilla ngjarje. Denoncohen me emër inspiruesit dhe autorët e sulmeve, sikundër shprehet solidariteti me familjarët e viktimave, popullin dhe shtetin e Izraelit. Padyshim roli i Shqipërisë në Lindje të Mesme është modest. Por qëndrimet politiko-diplomatike për këto ngjarje kanë një vlerë të pamohueshme në politikën e jashtme, pasi pasqyrojnë vlerat e popullit dhe vendit tonë. Për rrjedhojë, edhe renditjen përkrah aleatëve tanë të mëdhenj.

Ndërkohë që kanë kaluar dy javë prej sulmit terrorist të 24 shtatorit në Kosovë, të njëjtët krahë të politikës nuk gjejnë ende gjuhën e përbashkët për miratimin e një rezolute në Kuvendin e Shqipërisë, për dënimin e sulmit terrorist ndaj Kosovës dhe denoncimin me emër të inspiruesve dhe autorëve të sulmit, të cilët, i morën jetën në krye të detyrës policit Afrim Bunjaku.

Në memorien time do të mbetet gjithnjë e pashlyer seanca e Kuvendit të Shqipërisë, e 22

korrikut 2010. Teksa Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë shpallte në mënyrë solemne vendimin e saj për përputhshmërinë me të drejtën ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, në Kuvendin e Shqipërisë u shfaq një ekran i madh, ku deputetët pa përjashtim ndoqën me emocion seancën maratonë të Gjykatës së Hagës. Nuk kishte ngjarje më të rëndësishme për kombin. Ndaj, seanca parlamentare e 22 korrikut 2010 ishte në lartësinë që kërkonte ndërgjegjja kombëtare. Politika shqiptare dëshmoi dinjitet. Nuk kishte kalendar, program apo agjendë parlamentare të planifikuar që mund ta konkurronte atë ngjarje historike. Simbolika e seancës parlamentare ishte e qartë: çështja kombëtare ka përparësi ndaj politikës të ditës.

13 vite më pas, sherret banale, gara me projekt-rezolute dhe kërkesa për interpelancë, përçojnë mesazhin e papranueshëm se politika e vuvuzelave ka parakaluar çështjen kombëtare. Kjo nuk është në dinjitetin e politikës dhe as në nivelin e pritshmërisë së shoqërisë shqiptare. Kosova nuk është temë e politikës së jashtme dhe nuk mund të trajtohet as si temë e debatit të brendshëm politik. Kosova meriton të ketë vendin e saj të paprekshëm, pavarësisht rrethanave që prodhon politika e ditës. Nuk duhet të lejojmë që mungesa e vendosmërisë nga ana e Shqipërisë të trimërojë apo nxisë shtete ose grupe që kërkojnë zhbërjen e Kosovës.

Në rrethanat e tanishme politike dhe të sigurisë në Evropë sulmi terrorist i 24 shtatorit ndaj Kosovës është një kampion e fortë alarmi. Sjellja e Serbisë ndaj Kosovës nuk është më një çështje politike, por një çështje serioze e sigurisë për rajonin dhe të ardhmen e Evropës. Zgjedhja nuk është më mes dështimit dhe suksesit të dialogut, por ndërmjet stabilitetit dhe një përshkallëzimi të mëtejshëm të dhunës. Kjo e fundit ka të ngjarë të ndodhë nëse tolerohet roli i Serbisë, si prishëse e stabilitetit rajonal.

Politika duhet të ngrihet në lartësinë e kërkesave të shoqërisë shqiptare dhe të miratojë njëzëri një rezolutë në Kuvendin e Shqipërisë. Kuvendi i Shqipërisë ka plot burra e gra me dije dhe eksperiencë shtetërore që mund të hartojnë një dokument përbashkës që t'u qëndrojnë stuhive të kohës.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet të dënojë sulmet dhe provokimet e inspiruara nga Serbia kundër Kosovës, dhe të kërkojë bashkëpunimin e Serbisë me Kosovën, duke nisur nga dorëzimi i autorëve të sulmit dhe pranimit i një hetimi ndërkombëtar.

Kuvendi i Shqipërisë dhe qeveria shqiptare duhet të angazhohen në një përpjekje të mirëfilltë diplomatike për miratimin e një rezolute në Asambleenë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe emërimin e reporterëve të pavarur për të zbardhur rrethanat e kësaj ngjarje. Duke pasur parasysh

misionin dhe fushën e përgjegjësisë së Këshillit të Evropës, praktikën e konsoliduar me trajtimin e rasteve të tilla, por edhe faktin që Rusia nuk është më pjesë e kësaj organizate pan-evropiane në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut, Shqipëria duhet të kanalizojë energjitë politiko-diplomatike në funksion të përmbushjes së këtij objekti.

Në të njëjtën kohë, Shqipëria duhet t'i lehtësojë Kosovës paraqitjen e provave dhe fakteve në forumet dhe organizatat ndërkombëtare, ku Kosova nuk ka qasje, në lidhje me veprimtarinë e ekzekutorëve dhe urdhërdhënësve të sulmit terrorist.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet të mbështesë punën e të gjitha institucioneve të Kosovës në funksion të zbatimit të ligjit, rendit dhe mbrojtjes së integritetit territorial të Kosovës, e të nxisë bashkërendimin e ngushtë të institucioneve të zgjedhura të Kosovës me partnerët strategjikë: SHBA-të, BE-në dhe Mbretërinë e Bashkuar.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet të riafirmojë angazhimin e palëkundur të vendit tonë si anëtar i NATO-s dhe kandidat për në BE, në mbrojtjen dhe promovimin e arkitekturës së sigurisë rajonale, të mbështetur nga SHBA, NATO dhe BE, qysh prej rënies së perdes së hekurt, e cila bazohet në mosndryshimin e kufijve, bashkëjetesën ndëretnike, mbrojtjen e lirive dhe të drejtave

themelore të njeriut me fokus të pakicat, dhe pranimit të vendimeve të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Në këtë kontekst, partneriteti ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës është strategjik për ne, stabilizues për rajonin dhe orientues për të ardhmen euro-atlantike.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet të denoncojë politikën e revizionimit të historisë dhe glorifikimit të kriminelëve të luftës dhe akteve terroriste nga Serbia, si pengesë për paqen, stabilitetin dhe ardhmërinë evropiane të rajonit. Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet të përshëndesë angazhimin e aleatëve në NATO për shtimin e trupave të KFOR-it, si garanci për paprekshmërinë e perimetrit të sigurisë së Kosovës. Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet t'i bëjë thirrje pesë shteteve anëtare të BE-së, katër prej të cilave anëtare të NATO-s, që të njohin pavarësinë e Kosovës si kontribut për besueshmërinë e BE-së si ndërmjetësuese; zbatimin e planeve evropiane për rajonin; dhe në të njëjtën kohë, si mesazh ndaj Serbisë për të pranuar realitetin e pasluftës në ish Jugosllavi dhe për të ecur në drejtim të rrugës evropiane.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë duhet t'i bëjë thirrje vendeve anëtare të NATO-s për të përfshirë sa më shpejt Kosovën në Programin e Partneritetit për Paqe; dhe vendeve anëtare të BE-së për të filluar shqyrtimin e aplikimit për anëtarësim në BE.

Lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme pasurohet me 23 asete të reja

PRISHTINË, 8 TETOR - Ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, ka bërë me dije se lista e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme pasurohet me 23 asete të reja që shënojnë rrugëtimin historik dhe kulturor të vendit. “Nga shtëpitë

tradicionale, shkolla e parë shqipe e fillim shekullit të XX-të e kulla deri tek monumentet që pasqyrojnë historinë e fundit, në tërë territorin e Kosovës janë vlerësuar pasuri materiale dhe shpirtërore”, ka shkruar Çeku në “Facebook”.

Ai ka theksuar se në këtë listë janë shtuar afreskat e periudhës romake të Dresnikut, Guri i Nënës Pashkë, aset me vlera të jashtëzakonshme shpirtërore, ndërtesa e lokalit Panda në Pejë dhe ish-spitali ushtarak në Drenas që shënojnë

ngjarje historike. “Duke mbrojtur asetet tona, po kontribuojmë në njohjen dhe kuptimin e historisë së Kosovës teksa duke i kujtuar ngjarjet e kaluara formojmë identitetin kolektiv dhe kulturën tonë”, ka shkruar Çeku.



Arrestohet një person, dyshohet për planifikim të një sulmi terrorist në Kosovë

PEJË, 8 TETOR - Autoritetet gjyqësore në Kosovë njoftuan se kanë arrestuar një person që dyshohet se ishte përgatitur të kryente një “sulm të gjerë ndaj disa nxënësve të një shkolle në Pejë”. Prokuroria Speciale tha se i dyshuari B. M. për disa muaj

kishte bërë plane dhe përgatitje për këtë sulm. “Me këto veprime i pandehuri B. M. do ta kryente veprën penale ‘Përgatitja e veprave terroriste ose veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës’”, u tha në njoftimin e Prokurorisë Speciale. Prokuroria bëri me dije se

gjykata kompetente ka miratuar kërkesën e tyre dhe ndaj të dyshuarit është caktuar masa e paraburgimit prej një muaji. Sipas Kodit Penal të Kosovës, kushdo që përgatit kryerjen e një vepre terroriste mund të dënohet nga pesë deri në 20 vjet burgim.



Në Mitrovicë fillon vaksinimi i fëmijëve të moshës shkollore

Mitrovicë, 8 tetor - Shërbimi i Imunizimit dhe Vaksinimit i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr. Nexhat Çuni” në Mitrovicë ka filluar sezonin e ri të vaksinimit të fëmijëve të moshës shkollore.

Në procesin e vaksinimit do të përfshihen nxënësit e klasave I (e parë), VI (e gjashtë) dhe XII (e dymbëdhjetë).

Vaksinimi i nxënësve të klasave të para do të fillojë më 9 tetor, pastaj do të vazhdojë me vaksinimin e nxënësve të klasave të dymbëdhjeta, ndërsa vaksinimi për klasat e gjashta do të fillojë në fillim të vitit 2024.



Nxënësit e klasës së parë do të vaksinohen me vaksinën MMR, e cila është vaksinë kundër

fruthit, parotitit (shytave) dhe rubelles, vaksinën DT e cila është vaksinë kundër sëmundjes

së difterisë, tetanosit dhe vaksinën OPV, e cila është vaksinë kundër paralizës së fëmijëve.

Nxënësit e klasës së gjashtë do të vaksinohen me vaksinën DT, e cila është vaksinë kundër sëmundjeve të difterisë dhe tetanosit, vaksinën OPV e cila është vaksinë kundër paralizës së fëmijëve, dhe vaksinën HPV e cila është vaksinë kundër kancerit të qafës së mitrës që do të vaksinohen vetëm vajzat.

Nxënësit e klasës së dymbëdhjetë me vaksinën DT e cila është vaksinë kundër sëmundjeve të difterisë dhe

tetanosit.

Nga ky vit në kalendarin e vaksinimit të rregullt janë shtuar edhe tri vakcina të reja: HPV - vaksinë kundër kancerit të qafës së mitrës, vakcina Rotarix - vaksinë kundër infeksioneve me rotavirusë që do të aplikohet në dy doza, doza e parë te foshnjat dymuajshe, kurse doza e dytë në moshën katërmuajshe dhe vakcina Pneumowax- vaksinë për infeksionet e traktit respirator, e cila do të aplikohet për foshnjat e moshave dymuajshe, doza e dytë katërmuajshe dhe e fundit dymbëdhjetëmuajshe.

Nënshkruhet marrëveshja për ndërtimin e Qendrës Rezidenciale në Podujevë për të moshuarit

PODUJEVË, 8 TETOR - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, me kryetarin e shoqatës “Jetimat e Ballkanit”, humanistin Halil Kastrati, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunim për ndërtimin e Qendrës Rezidenciale për të Moshuar në

qytetin e Podujevës. Ky objekt do të ndërtohet në bashkëfinansim në mes të komunës së Podujevës (530 mijë) dhe Shoqatës “Jetimat e Ballkanit” (2 milionë euro). Objekti përveç qëndrimit ditor për të moshuar do ta ketë edhe kuzhinën popullore për ofrimin e

shujtave ditore për 200 persona, bujtinën, hapësira rekreative, parkun, shërbimin parësor shëndetësor, dhoma fizioterapeutike etj.

Kryetari Bulliqi e ka falënderuar hoqhën Halil Kastrati për ndihmën e vazhdueshme për

familjet nevojtare në Podujevë dhe për financimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm në qytetin tonë. Në fund kryetari Bulliqi i uroj të gjithë qytetarët për nënshkrimin e kësaj marrëveshje, veçanërisht i uroj të moshuarit që do t'i shfrytëzojnë këto hapësira.




Logopedët trajtojnë falas nxënësit me probleme në të folur

PRISHTINË, 8 TETOR - Mbi 20 nxënës të Shkollës Filllore “Mehmet Gjevori” në kryeqytet janë lajmëruar në kabinetin logopedik që nisi punën rreth dy javë më parë. Trajtimet në të folur për fëmijët po jepen falas nga Instituti Kosovar për Logopedi. “Terminët janë caktuar nga prindërit, kanë ardhur në kabinet dhe kanë

shprehur interesim për të caktuar termin me logopedin. Për momentin në secilën shkollë i kemi nga gjashtë logopedë vullnetarë”, tha drejtoresha e Institutit Kosovar për Logopedi, Ardita Uka-Rexha.

Shërbimet ofrohen nga ora 08:00 e mëngjesit deri në orën 12:00, ndërsa projekti

do të vazhdojë gjatë gjithë vitit shkollor. Në të njëjtën kohë me këtë institucion arsimor, iniciativa ka filluar edhe në shkollën “Asim Vokshi” e tek “Emin Duraku” zhvillohet qysh nga viti i kaluar. Kjo, sipas drejtorit të kësaj të fundit, Visar Osmani, thuhet se ka sjellë shumë përfitime për nxënësit.



Shërbime stabile të telefonisë mobile, jo para marsit 2024

PRISHTINË, 8 TETOR - Shërbimet e telefonisë mobile bien shpesh në Kosovë dhe qytetarët nuk mund të presin qëndrueshmëri të tyre së paku edhe gjashtë muaj. Në Telekomin e Kosovës thonë se problemi qëndron te vjetërsia e pajisjeve.

Më 3 tetor shërbimet e kësaj kompanie - përfshirë thirrjet dhe mesazhet - kanë rënë për disa orë. Reagimet e qytetarëve në mediet sociale kanë qenë të shumta.

“Çdo ditë kemi telashe”, shkruante një përdorues në “Facebook”. “S’ka valë që tri ditë”, shkruante një tjetër.

Në një deklaratë dhënë “Radios Evropa e Lirë” nga Telekomit thonë se “janë të vetëdijshëm dhe të përkushtuar që të reagojnë sa më shpejt dhe t’i zvogëlojnë pasojat” e problemeve. Por, nuk mund të zotohen për shërbime stabile para marsit të vitit 2024. Deri në atë kohë thonë se do të bëjnë investime të reja.

Telekomi i Kosovës në fund të vitit 2022 ka nënshkruar tri kontrata për zgjerim dhe modernizim të rrjetit mobil.

Vlera e këtyre kontratave kalon shumë prej 11 milionë eurosh.

Rreziqet nga rënia e shërbimeve

Inxhinieri i teknologjisë në Kosovë, Ermal Sadiku, thotë se rënia e shërbimeve të telefonisë mobile përcillet me disa rreziqe si në aspektin ekonomik, po ashtu edhe në atë social. Janë plot gjëra që nuk funksionojnë kur bien shërbimet e tilla, thotë ai. “Komunikimi është një nga gjërat më të rëndësishme sot në aspektin social dhe biznesor dhe ky pëson dëm të madh. Preket ekonomia, preket jeta sociale... Në rast rreziku, një person nuk mund të lajmërojë policinë apo zjarrfikësit”.

Sa iu përket aspekteve të sigurisë, Sadiku thotë se nuk beson se ato kanë rrezik. “Polica dhe ushtria kanë edhe sisteme të tjera të komunikimit”, sipas tij. Ngjashëm shprehet edhe Agron Dida, eksperti i telekomunikacionit, dikur udhëheqës i Post-Telekomit të Kosovës. “Nuk kam ndonjë njohuri për aspektet e sigurisë, do të thotë implikimet e ndërprerjeve të tilla në sigurinë e shtetit. Por, ato shërbime kanë një rëndësi të veçantë dhe duhet të



bëhet çmos që të avancohen”, thotë Dida për “Radios Evropa e Lirë”. Sipas tij, Telekomit i Kosovës duhet ta përcjellë teknologjinë dhe t’i rrisë kapacitetet me teknologji të reja për t’i evituar defektet.

ARKEP-i i bën vërejtje Telekomit

Nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) thonë se nga muaji korrik kanë ndërmarrë disa veprime ndaj operatorëve, të tilla si inspektime në terren dhe verifikime të ndryshme, në funksion të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë.

Në një deklaratë dhënë “Radios Evropa e Lirë”, ky autoritet thotë se është duke monitoruar situatën me ofrimin e qasjes dhe shërbimeve për konsumatorët.

“Në rast të mosveprimit të tyre në përputhje me vërejtjet, do të shqiptojmë masa në përputhje me kompetencat e deleguara me Kornizën Rregullatore për Komunikimet Elektronike”, thuhet në deklaratë.

Nga ARKEP-i thonë se i kanë dërguar vërejtje Telekomit të Kosovës për “mospërmbushje të përgjegjësisë që i ka ndaj konsumatorëve”, por se nuk kanë

iniciuar ndonjë procedurë për shqiptimin e sanksioneve të mundshme ekonomike.

“Shqiptimi i sanksionit ekonomik ndaj ndërmarrjeve/operatori është masa e fundit e cila vihet në përdorim për vendosjen e ligshmërisë dhe kjo vetëm atëherë kur të jetë e nevojshme dhe të kenë dështuar mjetet e tjera”, thonë nga ARKEP-i.

Në Ligjin për Komunikime Postare, neni 101 - sanksionet ekonomike - thuhet se çdo ndërmarrës/operator kur dështon të jetë në pajtim me aktet juridike, dënimet i ka deri në 7 % të të hyrave vjetore të ndërmarrësit. Por, nëse kalkulimi i një shume të tillë është i vështirë, ndërmarrësi/operatori dënohet me një shumë prej jo më shumë se 86 mijë eurosh.

Humbjet milionëshe ndër vite të Telekomit

Telekomi i Kosovës është kompani publike, e transformuar në shoqëri aksionare.

Qeveria e Kosovës është pronare e të gjitha aksioneve të Telekomit. Deri në vitin 2015 kjo ka qenë kompania më fitimprurëse në vend.

Nga viti 2008 deri më 2015 ajo i ka

paguar Qeverisë së Kosovës mbi 250 milionë euro dividendë - mjete që ndahen kur kompania shënon rezultate të mira financiare. Por, vite më pas, është përballur me përqendrim të situatës financiare. Kjo, sipas ekspertëve të telekomunikacionit, ka ndodhur si pasojë e kontratave të dëmshme, vendimmarrjes së gabuar, mungesës së investimeve, ndërhyrjes së politikës në vendimmarrje strategjike të kompanisë dhe nepotizmit.

Zyra Kombëtare e Auditimit, që është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar në Kosovë, ka raportuar në qershor të këtij viti se Telekomit në tetë vitet paraprakë ka operuar me humbje. Sipas raportit, humbjet e akumuluar deri më 31 dhjetor 2022 kanë arritur vlerën e 80 milionë eurove.

Nga Telekomit e Kosovës thonë për Radion Evropa e Lirë se aktualisht “gjendja është duke u përmirësuar në të gjitha drejtimet”, por se “sfidat dhe problemet ende ekzistojnë”. “Menaxhmenti dhe stafi i Telekomit janë duke punuar pa pushim, por përkundër rezultateve dhe përmirësimeve, ende kemi probleme me platforma të stërvjetruara, të cilat jemi duke i ndërruar”, thonë

në Telekom, por pa specifikuar më shumë.

Qeveria e Kosovës përmes Projektligjit për Fondin Sovran ka paraparë që ky fond t’i marrë në pronësi të gjitha asetet strategjike të vendit, përfshirë edhe Telekomin e Kosovës.

Fondi do ta ketë pastaj përgjegjësinë ekskluzive për të investuar në rritjen e vlerës së tyre. Projektligji për Fondin Sovran është miratuar në shqyrtim të parë në Kuvendin e Kosovës në korrik të këtij viti.

Sa paguajnë qytetarët për shërbime?

Në Telekomin e Kosovës operon telefonia fikse dhe ajo mobile Vala. Operatori Vala ka mbi 1.2 milion konsumatorë në nivel vendi. Qytetarët paguajnë shumën e ndryshme për shërbimet që marrin nga Telekomit i Kosovës.

Interneti në telefon, teknologjia 3G dhe 4G vetëm një ditë kushton 0.50 euro, ndërkaq për 31 ditë kushton 7.50 euro. Disa pako të tjera, ku hyjnë interneti, thirrjet mobile dhe fikse, si dhe shërbime të tjera, nisin nga 2.99 deri në 9.99 euro. Këto pako vlejnë nga dhjetë deri në 30 ditë.

Mashtrimet përmes shitjeve online, trend në Kosovë

PRISHTINË, 8 TETOR - Rreth 90 konsumatorë janë ankuar se kanë rënë pre e mashtrimeve nga shitjet online në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorit deri në shtator të këtij viti. Nga ky departament thonë se ankesat e tilla dërgohen në Inspektoratin e Tregut për shqyrtim dhe më pas veprojnë duke hartuar raportin në bazë të

procesverbalit. Ndërkaq, nga Shoqata “Konsumatori” potencojnë se duhet formuar Ministria e Konsumatorit në mënyrë që të ketë sa më pak raste të mashtrimeve.

Një qytetare nga Prishtina e cila ka dashur të mbesë anonim, për “KosovaPress” ka treguar se është mashtruar nga një faqe online në rrjetin social Instagram. Ajo tha se ka porositur një kostum, por ajo

që i erdhi ishte komplet diçka tjetër, derisa shtoi se nuk mori më kurrë përgjigje nga biznesi për ta ndërruar porosinë.

Lidhur me këtë çështje, kryetari i Shoqatës “Konsumatori”, Selatin Kaçaniku, tha se ka mbi 10 vjet që merren me problemin e porosive online, derisa shtoi se duhet krijuar Ministria e Konsumatorit.



Sfida më e madhe në gjysmë shekulli, për Izraelin



Nuk është shumë dramatike të thuhet se sulmi i djeshëm ishte sfida më e rëndësishme ushtarake ndaj Izraelit në gjysmë shekulli, që nga Lufta e Yom Kipurit e vitit 1973 (e njohur edhe si Lufta e Tetorit), kur një koalicion shtetesh arabe nisën së bashku një sulm të befasishtëm. Hamasi organizoi sulmin në shkallë të gjerë pothuajse 50 vjet nga dita e fillimit të atij konflikti. Dhe askush nuk e pa të vinte. Izraeli thotë se tani është shumë i vendosur për luftë.

“Ky nuk është një i ashtuquajtur operacion ushtarak, as një “raund” tjetër luftimesh”, deklaroi kryeministri Benjamin Netanyahu, teksa urdhëroi një rekrutim të gjerë rezervistësh dhe mobilizim të forcave për të luftuar. “Armiku ynë do të paguajë një çmim që nuk e ka parë kurrë. Jemi në luftë, do të fitojmë”. Retorika e kujdesshme që shfaqet ndonjëherë në fjalimet e zyrtarëve izraelitë në kohëra përshkallëzimi ushtarak, duke përfshirë fraza si “reagim proporcional” dhe “mbrojtje”, mungonte në këtë deklaratë. Këtë

herë është ndryshe. Dhe pasojat do të jenë të mëdha.

Fjalimi i Netanyahu ka të ngjarë të vendosë të gjitha opsionet në tryezë, nga një pushtim i afërt tokësor i Gazës, siç nuk e kemi parë kurrë më parë, deri te ridislokimi i mundshëm afatgjatë i ushtarëve izraelitë brenda Gazës. Do të ishte i pari që nga tërheqja e njëanshme e Izraelit nga Rripi i vogël i Gazës në vitin 2005.

Do të ketë pasoja për Bregun Perëndimor të paqëndrueshëm, të pushtuar, ku në muajt e fundit dhuna është rritur dhe ku rreth 200 palestinezë janë vrarë në sulmet ushtarake izraelite vetëm këtë vit. Izraeli ka të ngjarë ta zhvendosë egërsinë e reagimit, pasi të sigurojë jugun, në perëndim.

Negociatat e paqes midis izraelitëve dhe palestinezëve kanë qenë prej kohësh të vdekura, por çdo dritë shprese për të rindezur idenë e një zgjidhjeje me dy shtete, tani mund të shuhet.

Disa kanë argumentuar me kalimin e viteve, se Izraeli ka luajtur me kërcënimin ekzistencial të Hamasit dhe

fraksioneve militante të lidhura me të.

Tani e tutje, Izraeli do të përmendë 7 tetorin si shembull të një kërcënimi të tillë.

Për izraelitët, do të ketë pyetje të zhurmshe, se si ky sulm nuk u zbulua në radarin e inteligjencës. Izraeli është i famshëm si vendlindja e softuerit më të fuqishëm të mbikëqyrjes në botë. Ai ka sy mbi Gaza, që është vetëm 42 km i gjatë dhe 12 km i gjerë.

Kur jeni në Rripin e Gazës, e vetmja konstante është zhurma e pandërprerë e dronëve vëzhgues izraelitë në qiell. Ata kanë inteligjencë në terren. Ata kanë (ose kishin) pothuajse kontrollin e plotë të asaj që ndodh brenda dhe jashtë Gazës përgjatë kufijve të saj, pasi vendosën një bllokadë 16-vjeçare, pas marrjes së dhunshme të Rripit nga Hamasi në vitin 2007. Por me sa duket, ata nuk e kanë parë këtë sulm të afrohej.

Izraelitët në “zarfin e Gazës”, që janë zonat në Izrael rrotull Gazës, po strehohen në shtëpitë e tyre dhe fshihen ndërsa njerëz të armatosur të Hamasit bredhin

rrugëve. Të tjerë izraelitë u thanë rrjeteve lokale se militantët ishin në të vërtetë brenda shtëpive.

Pamjet filmike tregonin civilë izraelitë që vraponin për të shpëtuar jetën nëpër fusha. Klipe të tjera të shpërndara nga media e Hamasit, të cilat nuk mund të verifikoheshin në mënyrë të pavarur, tregonin militantët palestinezë duke mbajtur peng civilë izraelitë, duke marrë ushtarë robër dhe duke sjellë trupat e ushtarëve izraelitë në Gaza. Kishte pamje të gardhit kufitar të copëtuar dhe gjithashtu një tank të shkatërruar izraelit.

Grupi militant libanez Hezbollah, i cili mbështet Hamasin, tha se sulmi ishte një përgjigje ndaj “krimeve të okupimit dhe agresionit izraelit në vendet e shenjta” dhe synonte të dërgonte një mesazh të qartë për botën arabe dhe islame “veçanërisht atyre që përpiqen për normalizim”. Kjo deklaratë flet për Arabinë Saudite dhe SHBA. Uashingtoni po punonte për arritjen e një marrëveshjeje që do të normalizonte lidhjet midis Izraelit dhe Arabisë Saudite për herë të

parë, duke ndjekur hapat e Emirateve të Bashkuara Arabe.

Arabia Saudite lëshoi dje një deklaratë jashtëzakonisht të shpejtë duke bërë thirrje për “ndalimin e menjëhershëm të përshkallëzimit midis dy palëve”. Deklarata shtoi me kujdes se “mbretërisë i kujtohen paralajmërimet e saj të përsëritura për rrezikun e një situatë shpërthyes, si rezultat i okupimit të vazhdueshëm dhe privimit të drejtave të popullit palestinez.” A ka frikë Riadi nga dhuna brenda kufijve të tij?

Tani për tani situata është shqetësuese dhe gjithnjë e më e dhunshme. Policia izraelite, e cila po thërret gjithashtu të gjithë rezervistët dhe vullnetarët, tha se kishte “21 skena aktive” në jug të Izraelit, duke treguar shtrirjen e sulmit. Raketat ende godasin Izraelin jugor, sirenat ende dëgjohen. Ushtria izraelite nuk e ka marrë ende kontrollin e plotë të jugut.

E vetmja siguri është se ky është një moment përcaktues dhe i përgjakshëm në histori. / *The Independent* – Bota.al

Rokeri nobelist

Çmimi Nobel për Letërsi për vitin 2023, i është ndarë shkrimtarit 64-vjeçar norvegjez, Jon Fosse – “për dramën dhe prozën e tij novatore që ia japin zërin të pathënës”. Veprat e tij përfshijnë serinë e romaneve Septology, Alis at the Fire, Melancholy dhe A Shining.

“Vepra e tij e madhe, që përfshin shumëllojshmëri të zhanreve, mbërthen rreth 40 drama dhe një mori të romaneve, përmbledhje të poezive, eseve, librave për fëmijë dhe përkthime”, ka thënë Anders Olsson, kryetar i Komitetit të Nobelit për Letërsinë. “Fosse në gjuhë dhe në natyrë ndërthur rrënjët e prejardhjes së tij norvegjeze, bashkë me teknikat artistike të modernizmit”.

Jacques Testard, botuesi i letërsisë të Fossesë, kur dëgjoi lajmin tha: “Është shkrimtar i jashtëzakonshëm, i cili ka arritur të gjejë një mënyrë krejtësisht unike për të shkruar letërsi. Siç e tha kohët e fundit redaktorja e tij norvegjeze – Cecilie Seiness, në një intervistë – nëse hap ndonjë libër të Jonit dhe lexon disa rreshta, ato nuk mund të shkruhen nga askush tjetër. Letërsia e tij është e mrekullueshëm, mistike dhe e rrënjësuar në peizazhin e fitorëve perëndimore ku ai u rrit. Është e rëndësishme të kujtojmë se ai shkruan në ninorshk, ose në norvegjishten e re, një gjuhë e pakicës në Norvegji, gjë që në



vetvete paraqet një akt politik. Ai është gjithashtu dramaturg dhe poet i jashtëzakonshëm. Është mendje e jashtëzakonshme”. Kritikja Catherine Taylor, për këtë çmim ka thënë: “Të lexosh veprën e Jon Fossesë, kjo është një përvojë e thellë, shpirtërore, për të mos thënë fetare. Fosse ka pohuar se ‘ne në fakt jemi të dëshiruar për Zotin, sepse qenia njerëzore është një lutje e vazhdueshme’ – dhe, pavarësisht nëse kjo është e vërtetë apo jo,

librat e tij nuk janë asgjë më pak se një mrekulli.”

I lindur në vitin 1959 në Haugesund në bregun perëndimor të Norvegjisë, Fosse u rrit në Strandebarm. Në moshën shtatëvjeçare ai gati vdiq në një aksident, për të cilin tha se ishte “përvoja më e rëndësishme” e fëmijërisë së tij dhe se kjo atë “e krijoi” si artist. Në adoleshencë aspiroi të bëhej kitarist i muzikës rok, përpara se t’i kthente ambiciet në shkrim.

Romani i tij debutues, Raudt, svart (E kuqe, e zezë), u botua më 1983. Drama e tij e parë që u shfaq, Og aldri skal vi skiljast (Dhe, kurrë nuk do të ndahemi), u vu në skenë në Teatrin Kombëtar në Bergen. Në vitin 1994. Megjithatë, drama e parë që shkroi, Nokon kjem til å komme (Dikush do të vijë), do të shpie në zbulimin e tij në vitin 1999 – pasi regjisori francez Claude Régy atë e inskenoi në Nanterre. Dramat tjera që ka shkruar Fosse

janë Namnet (Emri), Vinter (Dimri) dhe Ein sommars dag (Një ditë vere). Veprat e tij më të gjata përfshijnë trilogjinë Septology, vëllimi i tretë i së cilës u përfshi në listën e ngushtë për çmimin ndërkombëtar Booker më 2022. Septology, të cilën Fosse e filloi gjatë një pauze nga dramaturgjia dhe pasi u konvertua në katolicizëm në vitin 2013, ka të bëjë me piktorin e moshuar Asle, që jeton i vetëm në bregun jugperëndimor të Norvegjisë dhe që reflekton mbi jetën e vet. Atje, në Bjorgvin, jeton një tjetër Asle i cili gjithashtu është piktor, por që lufton me varësinë ndaj alkoolit. Jeta e dyfishtë konsumohet nga të njëjtat pyetje ekzistenciale për vdekjen, besimin dhe dashurinë.

Në vitin 1989, të njëjtin vit kur doli romani Naustet (Shtëpia varkë), shkrimtari i jepte mesime autorit tjetër norvegjez, Karl Ove Knausgård, që ishte student në Akademinë e Shkrimit në Hordaland. “Zëri i Fossesë është i pagabueshëm në çdo gjë që ai shkruan”, shkroi Knausgård më 2019.

Para Nobelit, Fosse ishte shkrimtar i nderuar me shumë çmime. Në vitin 2003 merr Urdhrin Kombëtar të Meritave të Francës, ndërsa më 2007 fitoi çmimin Nordik të Akademisë Suedeze. Në vitin 2010 fitoi Çmimin Ibsen (në fakt është quajtur “Henrik Ibsen i ri”). Atij më 2014 iu nda edhe Çmimi Evropian për Letërsi. /Telegrafi/

Kur nobelisti Pablo Neruda i shkruante Enver Hoxhës

Nga: Roland QAFOKU

Shkrimtari, poeti dhe nobelisti kilian Pablo Neruda ka qenë i njohur për pikëpamjet e tij antifashiste. Për këtë dhe për talentin e tij, ka qenë i përkthyer edhe në Shqipërinë e pasluftës së Dytë Botërore.

Por, nuk dihej afeksioni i tij për regjimin stalinist të Enver Hoxhës duke e mbështetur hapur atë. Këtë e vërteton një telegram i shkruar prej Nerudës në adresë të diktatorit Enver Hoxha, 68 vjet më parë. Dhe a e dini për çfarë? Për nder të 10-vjetorit të themelimit të Partisë Komuniste të Shqipërisë!

Në arkivin tim zbulova se në një broshurë-libër të botuar nga Komiteti Qendror i PPSH-së në vitin 1951, shkrimtari kilian i është drejtuar personalisht Enver Hoxhës, në atë kohë sekretar i Përgjithshëm i partisë dhe kryeministër, përmes një letër-telegrami.

Ishte normale për atë përvjetor



që Enver Hoxhës t’i shkruanin liderë komunistë nga Bota, si Mao Ce Duni i Kinës dhe Kim Ir Seni i Koresë së Veriut e të tjerë liderë komunistë, gjë që e kanë bërë. Por, që pas tyre një gjë të tillë ta bënte edhe Pablo Neruda, i cilësuar nga Gabriel Garcia Marquez si poeti më i madh i shekullit të XX, kjo është diçka më

shumë se sa habi.

Madje, në fjalët drejtuar Enver Hoxhës, Neruda zbulon se ka patur edhe ftesë zyrtare të posaçme në adresë të tij të vinte në Shqipëri për të marrë pjesë në festimet e 10-vjetorit të themelimit të Partisë së Punës së Shqipërisë. Kjo tregon se marrëdhënia e Pablo Nerudës

me Enver Hoxhën nuk ka qenë vetëm formale. Vetë Neruda sqaron se ka patur shumë dëshirë ta bënte realitet vizitën, por angazhime e tjera nuk ia kanë mundësuar.

Çdo të ndodhte nëse nobelisti do vinte në Shqipëri? Nuk dimë ta themi këtë, por të paktën do kishte një dëshmitar i profilit të

lartë për të parë me sytë e vetë “mrekullinë e tetë të botës”. Ku i dihej, zhgënjimi mund ta frymëzonte për të shkruar ndonjë poezi a roman. Megjithatë, letra e shkruar ndaj diktatorit Hoxha flet më shumë se sa supozimet.

Më poshtë fjalët drejtuar Enver Hoxhës:

“Shokut Enver Hoxha Sekretar i Përgjithshëm i Partisë së Punës së Shqipërisë,

Tiranë

Detyrat e Këshillit Botëror të Paqes më ndalojnë udhëtimin për në Republikën Popullore të Shqipërisë, të cilën do të dëshiroja shumë ta vizitoja. Lutemi pranoni në këtë përvjetor përshëndetjet e mijta të nxehta për qeverinë tuaj popullore dhe dashurinë time për popullin shqiptar.

Pablo Neruda”.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Sot grumbullohet Kosova A në hendboll

PRISHTINË, 8 TETOR - Të hënën bëhet grumbullimi i hendbollistëve të Kombëtares së Kosovës. Grumbullimi bëhet prej orës 12:00 deri në ora 13:00 në Hotel International Prishtina. Stërviija e parë e vajzave tona

është të hënën prej orës 19:30 deri në ora 21:00 në palestrën "1 Tetori" në Prishtinë. Të mërkurën në mëngjes është udhëtimi për në Horsens të Danimarkës, ku të enjten prej orës 21:00 është ndeshja me Danimarkën. Ndeshja i takon

xhiros së parë të kualifikimeve për Euro 2024. Menjëherë të shtunën është ndeshja Kosova – Danimarka, në Prishtinë. Danimarka është superfuqi e hendbollit, ndërsa ndeshjet ndaj saj do të shërbejnë për rritjen e

mëtejme të Kombëtares sonë. Tashmë të grumbulluara në Prishtinë janë Kombëtares U19 dhe U17 që javën tjetër paraqiten në IHF Trophy. Të dy kombëtares e reja të dielën i kanë zhvilluar stërviitjet e radhës.



Prishtina ndahet në paqe me Ballkanin, Llapi mposhti Lirinë "Epoka e re"

PRISHTINË, 8 TETOR - Derbi i javës së 9-të në Albi Mall Superligën e Kosovës në futboll, ndërmjet Prishtinës dhe Ballkanit, i cili u zhvillua në orët e mbrëmjes në stadiumin "Fadil Vokrri" në kryeqytet ka përfunduar pa fitues, me shifrat 1:1. Të parët në epërsi kaluan mysafirët nga Suhareka, me golin e shënuar nga Nazmi Gripshi, në minutën e 30-të. Megjithatë, reagimi i Prishtinës erdhi shumë shpejt, ngase vetëm katër minuta më pas Jalen Blesa shënoi nga afërsia. Pas këtij barazimi Ballkani vazhdon të kryesojë renditjen me 20 pikë, derisa bardhekaltrit e kryeqytetit mbesin në pozitën e pestë, por tani me 12 pikë. Llapi ka shënuar fitore shumë të rëndësishme në duel me Lirinë, në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë, me rezultat 2:0, në kuadër të javës së 9-të në Albi Mall Superligë.

Deri te kjo fitore llapjanët erdhën me mjaft vështirësi, pasi në një periudhë të lojës ishin me dy lojtarë më pak në fushë pas përjashtimit të Besar Musollit (25') dhe Ahmed Januzit (75'). Gjithsesi, kontribut të madh në këtë fitore dha edhe portieri Ilir Avdyli, i cili në minutën e 51-të e mbrojti gjuajtjen e Festim Alidemës nga penalltia. E pikërisht kur mbeti me dy lojtarë më pak me fushë skuadra e Tahir Batatinës arriti të kalojë në epërsi. Ishte Muhamed Hyseni, ai i cili fitoi penallti, të cilën më pas e shndërroi në gol, duke i dhënë epërsinë skuadrës së tij. Gjërat për llapjanët u bënë më të lehta kur gjyqtari Dardan Çaka e përjashtoi nga loja edhe lojtarin e Lirisë, Aprocus Megameno (79'), pas ndëshkimit me kartonin e dytë të verdhë, teksa gabimin e mbrojtjes prizrenase në minutën e 86-të e shfrytëzoi i



rikthyeri në radhët e Llapit, Valmir Veliu, duke vulosur rezultatit përfundimtar 2:0. Drita ka shënuar fitoren e katërt radhazi në Albi Mall Superligë dhe të pestën në këtë edicion. Skuadra e drejtuar nga trajneri grek Akis Vavalis, në kuadër të javës së 9-të ka shënuar fitore si mysafirë në Suharekë në përballje me

Malishevën, me rezultat 3:1. Goli i parë u shënuar në minutën e 41-të, kur Dreni Kryeziu shënoi autogol pas harkimit të Blend Fazliut. Paraprakisht Drita e gjeti rrugën e golit edhe në minutën e 7-të përmes Astrit Thaçit, por ai u anulua nga VAR-i. Epërsinë në 2:0 e shtoi Besnik Krasniqi para shkuarjes në pushim, në

minutën e tretë të kohës shtesë. Malisheva e nisi më mirë pjesën e dytë dhe arriti ta ngushtojë epërsinë në minutën e 58-të përmes Elom Nyavedji, me gjuajtje me kokë. Ndërkohë rezultatit përfundimtar 3:1 e vendosi Muharrem Jashari, në minutën e 10-të të kohës shtesë. Fitore të rëndësishme ka arritur edhe Feronikeli 74, që e ka mundur Fushë Kosovën në stadiumin "Rexhep Rexhepi" në Drenas, me rezultat bindës, 3:0. Golat për "Niklin" i shënuan Ibrahim Cërvadikut në fund të pjesës së parë, Jakup Berisha nga penalltia, në minutën e 65-të, derisa tre minuta më vonë Florent Avdyli vendosi rezultatit përfundimtar. Në ndeshjen e tretë të ditës së sotme, Gjilani dhe Dukagjini kanë luajtur baras, 1:1. Të parët në epërsi kaluan mysafirët me golin e Bujar Shabanit, në minutën e 29-të, derisa një pikë Gjilanit ia siguroi Kushtrim Shabani, me golin e shënuar në minutën e 60-të.

Fitorja e parë për Istogun në elitë

ISTOGU, 8 TETOR - Istogu ka regjistruar fitoren e parë në elitë. Istogasi në Prizren ia kanë shkaktuar humbjen e parë këtë edicion Bashkimit me rezultat 83:77 (15:19, 21:20, 22:16, 25:22). Ndeshja u zhvillua në kuadër të javës së tretë të Prince Caffë Superligës. Pas një fillimi të barabartë prej 9:9, prizrenasit shkëputen në 9:18, megjithatë istogasi afrohen dhe çereku i parë përfundon 15:19. Prizrenasit shkëputen në periudhën e dytë, 20:31, por istogasi sërish afrohen dhe pjesa e parë përfundon 36:39. Por, istogasi nuk ndalen dhe në periodën e tretë përmbysin

rezultatit në 56:49, kurse kësaj radhe prizrenasit afrojnë rezultatit në 59:56, sa ishin shifrat pas 30 minutash. Në dhjetë minutat e fundit u zhvillua lojë interesante, por sidoqoftë, skuadra nga Istogu arriti të menaxhojë mirë epërsinë e krijuar dhe fitoi 83:77. Për Istogun kjo ishte fitorja e parë në elitë, derisa numëron edhe dy humbje, kurse kjo ishte humbja e parë për Bashkimin pas dy fitoreve radhazi. Te Istogu u dalluan Arian Azemi me 15 pikë, gjashtë kërcime e 11 asistime, Kahlon



Whitley me 27 pikë dhe Matthew Lang me 23 pikë, kurse te Bashkimi u dalluan Erik Copes me 16 pikë e 12

kërcime, Jeremy Harris me 15 pikë e gjashtë kërcime dhe Grant Lozoya me 21 pikë. Në një ndeshje interesante dhe me kthesa, Sigal Prishtina ka mundur Golden Eagle Yllin me rezultat 99:74 (24:12, 26:23, 18:21, 31:18). Pas një fillimi të barabartë, prishtinasit filluan të shkëputen dhe e fituan çerekun e parë bindshëm, 24:12. Periudha e dytë ishte më e barabartë, sidoqoftë, vendasit e kontrolluan lojën dhe shkuan në pushim me shifrat 50:35. Bardhekaltrit e

filluan furishëm pjesën e dytë, dhe të inspiruar nga Dardan Berisha arrijnë epërsi prej 25 pikësh, 66:41, por kundërpërgjigja e Yllit nuk vonoi, k Gëzim Morina ishte lider, duke shkëputur epërsinë në 68:56, sa ishte rezultatit pas 30 minutash. Mysafirët ngushtuan edhe më shumë epërsinë në 70:62, por Prishtina nuk lejoi përmbysjen e madhe dhe sërish u shkëput në 78:62, e më pas triumfoi në fund me rezultat 99:74. Më i miri i ndeshjes ishte Dardan Berisha me 25 pikë. Tani prishtinasit kanë dy fitore e një humbje, kurse therandasit një fitore e dy humbje

Arsenali fiton pas 8 vjetësh ndaj Cityt në Emirates

LONDËR, 8 TETOR - Arsenali rikthehet të fitojë në Premier League kundër Manchester City në fushën e vet pas 8 vitesh. Skuadra e Mikel

Artetës iu fal goli të Gabriel Martinellit për të thyer kampionët në fuqi. Braziliiani shënoi golin vendimtar katër minuta përpara fundit pas një

topi të marrë nga Kai Havertz. Vendasit patën edhe fat, pasi gjuajtja e brazilianit u devijua nga Nathan Ake. Sfida ishte tepër e luftuar, por rastet për

shënim ishin të pakta. Arsenali në këtë mënyrë parakalon Cityt në renditje dhe arrin Tottenhamin në kreun e tabelës.



